

## **NË EMER TE POPULLIT**

**Gjykata Themelore ne Gjilan, Departamenti per Krime te Rënda,** duke vendosur sipas kryetarit te trupit gjykues Naser Maliqi, me Zyrtaren ligjore Zahide Rexhepi, ne qeshtjen penale te te pandehurit XH. B.nga fshati L. I P.- Gj., per shkak te vepres penale mbajtja ne pronesi, ne kontroll, ose posedim te paautorizuar te armeve nga neni 374 parag.1 e KPRK-se , te cilin e mbron av.F. B. sipas detyres zyrtare dhe e sipas aktakuzes se Prokurorise Themelore ne Gjilan, Departametni per Krimet e Renda, PP/ I. nr.189/ 201624.08.2016 e dt. 24.08. 2016, e pas mbajtjes e shqyrtimit fillestar me dt. 06.10.2016, shpalle:

## **AKTGJYKIM**

**I pandehuri XH. B.** nga babai E. dhe e ema R., e lindur Q., i lindur me dt. ... ne fshatin L. i U., ku edhe jeton, ka te kryer shkollën e mesme, i pa pune, i martuar, baba i ... femive, i gjendjes se mesme ekonomike, shqiptar, i R, te Kosoves.

## **WSHTE FAJTORË**

### **I.**

Ne kohe te pa vertetuar me pare ne manure te paautorizuar ka mbajte ne pronesi, arme te zjarre edhe ate ..., prodhim turk me numer serik caliber ..., e cila ishte prone e ... tani te ... e cila ishte me afat te skaduar, e te cilen edhe me 26. 07. 2016, te njejten arme e ka dorezuar ne manure vullnetare dhe e njejta gjendet e sekuestruar nga Policia e Kosoves, Stacioni Policor ne GJilan.

-Me qka cka ka kryer veper penale penale perdorimi I armes apo mjetit te rrezikshem nga neni 375 par.2 te parag. 1. Te KPRK-se.

-Me cka ka kryer veper penale, mbajtja ne pronesi, ne kontroll, ose posedim te paautorizuar te armeve nga neni 374 parag. 1 te KPRK-se.

-Andaj ne baze te nenit 4,7,17,21,41,46,51,73,76,80,86 te KPRK-se, dhe nenenve 365 dhe 453 te KPPRK-se

## **E GJYKON**

**Me denim gjobe** ne shume prej 300 euro( treqinde euro), te cilin denim do ta paguaj ne afat prej 15 ditesh pas plotfuqishmerise se ketij aktgjykimi, ne te kunderten ky denim do te zevendesohet me denim burgu me nga 20 euro, per nje dite burgu,

**Konfiskohet pushka e gjuetise prodhim turk me numer serik 12892 caliber 12 CA,** konform nenit 374 paragrafi 3, te KPRK-se.

## **ARSYETIM**

**Prokuroria Themelore ne Gjilan, Departamenti per Krime te Renda,** me dt.24.08.2016, ka ngritur aktakuzen PP/I, nr. 189/ 2016, ndaj te pandehurit XH. B. per shkak te vepres penale ,mbajtja ne pronesi, ne kontrole, ose posedim te paautorizuar te armeve nga neni 374 parag. 1 te KPRK-se, dhe ka kerkuar qe pas mbajatjes se shqyrtimit gjyqësor, I njeti te shpallet fajtor dhe te denohet me denim meritor sipas ligjit.

**Kryetari I trupit gjykues, me dt.06.10.2016,** ka mbajtur seancen fillestare, ne te cilen I pandehuri XH. B. ka pranuar ne tersi vepren penale e cila I vihet ne barre sipas dispozitivit I te atkakuzes, e ndien veten fajtor dhe ka kerkuar falje, duke cekur se ne te ardhmen nuk do te perseris vepra te tilla penale, I njeti ka deklaruar se pranimin e fajsise e ka bere ne menyre vullnetare dhe pa presion nga askush dhe se eshte I vetedijshem per pasojat e ketij pranimi si dhe ne konsulltim me avokatin e tij, F. B. .

**Prokurori I shtetit Afrim Shefkiu** ka deklaruar se nuk e kundershton pranimin e fajsise nga ana e te pandehurit, sepse ky pranim eshte ne perputhje me dispozitat ligjore dhe provat qe gjinden ne shkresat e lendes.

**Mbrojtesi I te pandehurit XH. B.** av. F. B. ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimin e fajësive nga ana e të mbrojturit të tij dhe se ky pajtim është bërë në mënyrë vullnetare dhe pas konsultimeve me të për pasojat dhe benifitet e saj.

**I pandehuri XH. B.** ka deklaruar se e përkrahi në tërësi fjalën e avokatit të tij pa ndryshime, dhe ka kërkuar nga gjykata që të t' i shqiptoi një dënim sa më të butë, për shkak se të njëjten pushkë e kam dorëzuar vetë e të cilën e ka pas trashëgim nga babai i tij.

Gjykata e ka aprovuar këtë pranim të fajësive, pas marrjes së mendimit nga ana e prokurorit të shtetit, nga mbrojtësi I tij dhe nga vetë I pandehuri për shkak se ky pranim është bërë në mënyrë vullnetare, pa imponim dhe pa asnjë presion, duke i ditur pasojat e pranimit të fajësive nga ana e të pandehurit.

Gjatë marrjes dhe shqiptimit të dënimit, Gjykata ka patur parasysh sjelljen e mirë të të akuzuarve në Gjykatë, pranimin e fajësive nga ana e të pandehurve, janë penduar thellë për kryerjen e ketyre veprave si dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejnë vepra të tilla, nuk janë të njohur si recidivist. Gjithashtu Gjykata ka marrë për bazë si rrethanë lehtësuese se të njëjtin tani janë pajtuar në mes vetë dhe nuk ekziston më kurrfarë konflikti në mes tyre .

Për këtë arsye u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, ku I akuzuari E. A. është shpallur fajtor dhe gjykuar me dënim me gjobe për veprën penale nën dispozitivin I. në shumë prej 300 euro, ndërsa për veprën nën dispozitivin II, Gjykata I ka shqiptuar dënim burgu në kohezgjatje prej 6 muajve, të cilin dënim burgu I pandehuri nuk do ta vuajë nëse në periudhën kohore prej 2 viteve nuk kryen vepra tjeter penale, në të kundërtën dënimi I kushtëzuar do të revokohet.

Ndërsa të pandehurit A. A. I është shqiptuar vërejtje gjyqësore, duke marrë parasysh rrethanat lehtësuese të përmendura më lartë, sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale, e I cili është pajtuar me të akuzuarin E. A., që vertetohet edhe nga deklaratat e këtij të fundit.

**I pandehuri E. A.** është detyruar që në emër të paushallit gjyqsor të paguaj shumën prej 30 euro, ndërsa **I pandehuri A. A.** shumën prej 20 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmerisë së këtij aktgjykimi.

**Te pandehurit E. A.** I është konfiskuar arma e zjarre dhe atë ...te markes” ...”, e kalibrit ... mm, pa magnum me nr. serik ... dhe ... karikatore pa fisheke, konform neni 374 paragrafi 3, të KPRK-se. .

**GJYKATA THEMELORE NE GJILAN**  
**DEPARTAMENTI PER KRIME TE RENDA**  
**Me dt, 15. 01.2016**

**Sek. Jurdike,**  
**gjkues:**  
**Zahide Rexhepi**

**Kryetari I trupit**  
  
**Naser Maliqi**

**KSHILLA JURIDIKE:** kundër këtij aktgjykimi, palet e paknaqura mund të ushtrojne ankese në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, e nëpërmes kesaj Gjykate.